

Vendim nr. 57 datë 17.03.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 17.03.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (A) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ARBEN BRAHJA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1584, datë 04.07.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pezullimi i zbatimit të ekzekutimit të këtij vendimi deri në përfundimin e gjykimit.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” (*ligji nr. 7501/1991*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Arben Brahja ka pasur cilësinë e palës së paditur në procesin gjyqësor të kundërshtuar me kërkesën në shqyrtim dhe së bashku me palët e tjera ndëgjyqëse janë trashëgimtarë ligjorë të shtetasit A.B.(M).

2. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” (ligji nr. 7698/1993), trashëgimtarët e shtetasit A.B.(M) i janë drejtuar Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave (KKKP). Me vendimin nr. 12, datë 16.03.2001 të KKKP-së, trashëgimlënësit A.B.(M), në bazë të nenit 1 të ligjit nr. 7698/1993, i është njohur pronësia mbi një sipërfaqe toke prej 12,344 m², të ndodhur në fshatin Sauk të Tiranës, në perëndim të Pallatit të Brigadave, si dhe kthimi e kompensimi i saj si vijon: *“Për truallin e lirë me sipërfaqe 5,270 m² i kthehet pronësia mbi të; për truallin me sipërfaqe 7,074 m², brenda së cilës është ndërtuar Vila nr. 5, kompensohet në një nga mënyrat e përcaktuara në nenin 16 të ligjit nr. 7698/1993.”*.

3. Po kështu, me vendimin nr. 1035, datë 15.04.2003 të KKKP-së, trashëgimlënësit A.B.(M) i është njohur pronësia mbi një truall me sipërfaqe 132,994 m², të ndodhur në Sauk të Tiranës (pika 1 e vendimit), nga e cila i takon për kthim dhe kompensim, në bazë të nenit 5 të ligjit nr. 7698/1993, sipërfaqja 19,453.4 m². Nga kjo e fundit, duke qenë se 5,270 m² janë kthyer të lira me vendimin e sipërcituar të KKKP-së nr. 12, datë 16.03.2001, për sipërfaqen 14,183.4 m² i është njohur e drejta për kompensim në bazë të nenit 16 të ligjit nr. 7698/1993 (pika 2 e vendimit). Në vendimin e KKKP-së është disponuar edhe se, meqenëse ish-pronari A.B. ka ndërruar jetë, e drejta e pronësisë mbi këtë pronë u kalon trashëgimtarëve të tij ligjorë sipas pjesëve takuese në dëshmitë e trashëgimisë nr. 397, datë 14.02.1994 dhe nr. 2673, datë 20.06.2002 për trashëgimtarët e shtetases M.K.(B).

4. Rezulton, gjithashtu, se në bazë të ligjit nr. 7501/1991 “, Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Sauk, pas vitit 1993, ka pajisur me akte të marrjes së tokës (AMTP) në pronësi, në parcelat ku ka qenë ish-ndërmarrja bujqësore “Gjergj Dimitrov” disa shtetas që u përkasin familjeve Brahja, trashëgimtarë të ish-pronarit A.B., dhe konkretisht: M.B. me 5,500 m²; H.B. me 7,400 m²; M.B. me 7,400 m²; A.B. me 3,600 m²; M.B. me 6,300 m²; A.B. me 3,600 m²; S.B. me 3,600 m²; SH.B. me 3,600 m²; G.B. me 3,600 m²; B.B. me 3,600 m², H.B. me 24,290 m²; I.B.(M) me 28,288 m² dhe I.B. me 7,400 m².

5. Paditësja N.B., në cilësinë e trashëgimtares ligjore të ish-pronarit A.B.(M), i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, duke kërkuar: *“Anulimin e pikës 1 të vendimit 1035, datë*

15.4.2003 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, Prefektura e Qarkut Tiranë, që ka si bazë ligjore ligjin nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave”, dhe të njihen bashkëpronarë e të deklarojnë të pavlefshëm aktet e pronësisë të paditurve të ndara sipas ligjit për tokën, me pretendimin se janë trashëgimtarë të ish-pronarit A.B.(M).”.

6. Ajo ka thirrur në këtë gjykim, në cilësinë e palës së paditur, trashëgimtarët Brahja, njëri prej të cilëve është edhe kërkuesi, të cilët kanë përfituar nga vendimet e KKKP-së. Në këtë gjykim kanë hyrë si ndërhyrës kryesorë edhe trashëgimtarët e tjerë të ish-pronarit Brahja, duke pretenduar “se mbi sipërfaqen e tokës që u është dhënë të paditurve kanë të drejta pronësie paditësja dhe ndërhyrësit kryesorë. Të paditurit e kanë përfituar tokën si trashëgimtarë të A.B.(M), pasi ata kanë qenë banorë të qytetit dhe toka ka qenë brenda vijave të verdha të qytetit të Tiranës. Sipërfaqja e tokës është dhënë në zbatim të ligjit “Për tokën” dhe të vendimit 452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”. E drejta e pronësisë u takonte të gjithë pjesëtarëve të trashëgimtarëve A.B.(M), si dhe paditëses dhe trashëgimtarëve të M.K. të cilët nuk janë përfshirë”.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4978, datë 07.05.2013, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditëses N.B. dhe kërkesëpadisë së ndërhyrësve kryesorë, si të pabazuara në ligj e në prova.”. Sipas gjykatës: “Pretendimi i palës paditëse nuk bazohet në asnjë dispozitë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, për rrjedhojë paditësi nuk legjitimohet si subjekt përfitues i ligjit për tokën. Ato nuk mund t’i kundërshtojnë këto akte gjyqësorë dhe njëherazi rezulton se aktet e tokës në pronësi të të paditurve nuk janë kundërshtuar as në rrugë administrative, që tregon se ato nuk legjitimohen në këto kërkitime të padisë as në rrugë gjyqësore ndaj palës së paditur.”. Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim në gjykatën e apelit pala paditëse dhe ndërhyrësit kryesorë në procesin gjyqësor.

8. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 679, datë 31.03.2015, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 4798, datë 27.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Konstatimin e pavlefshëm të akteve të marrjes së tokës në pronësi...anulimin e pjesshëm të pikës 1 të vendimit nr. 1035, datë 15.04.2003 të KKKP-së, Prefektura e Qarkut Tiranë për sipërfaqen S2 të barabartë me 108,178 m². Ti njohë pronësinë dhe t’u kthejë në natyrë trashëgimtarëve ligjorë të ish pronarit A.B. sipërfaqen prej 108,178 m², në pjesë takuese sipas trashëgimisë ligjore të të

ndjerit A.B.”. Kundër këtij vendimi pala e paditur në procesin gjyqësor ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

9. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1584, datë 04.07.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se konkluzionet e arritura nga gjykata e apelit janë rrjedhojë e hetimit të plotë të çështjes dhe se pretendimet në rekurs që ngrenë çështje të vlerësimit të provave dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të asaj gjykate.

10. Me kërkesën e datës 01.11.2022 kërkuesi Arben Brahja dhe shtetasit Sami Brahja etj., i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë me objekt: “*Shfuqizimi i vendimit nr. 679, datë 31.03.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 00-2022-1584, datë 04.07.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë me tjetër trup gjykues. Pezullimi i zbatimit të ekzekutimit të vendimeve të mësipërme deri në përfundimin e gjykimit.*”.

11. Në datën 04.01.2023 kërkuesi Arben Brahja i është drejtuar Gjykatës me një kërkesë të re me të njëjtin objekt (kërkesa në shqyrtim). Kjo kërkesë është nënshkruar nga përfaqësuesja e zgjedhur nga kërkuesi, sipas aktit të përfaqësimit bashkëlidhur kërkesës.

II

Pretendimet e kërkuetit

12. **Kërkuesi** ka pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se është cenuar:

12.1. *Parimi i sigurisë juridike dhe gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka cenuar vendimet e formës së prerë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, por edhe aktet administrative të nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjit, siç janë ATMP-të, për sa kohë këto akte janë në fuqi dhe prodhojnë rregullisht efektet e tyre, si dhe nuk janë shfuqizuar apo ndryshuar nga organi administrativ që i ka nxjerrë apo me vendime gjyqësore. Gjykata e apelit pa argumente faktike dhe ligjore ka mbajtur një qëndrim diametralisht të kundërt me atë të gjykatës së shkallë së parë, duke dhënë një vendim haptazi të padrejtë dhe që në themel nuk ka zgjidhur konfliktin gjyqësor. Po ashtu, Kolegji Civil nuk ka respektuar fuqinë detyruese të vendimeve të Gjykatës.

12.2. *E drejta e aksesit në gjykim*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet ta shqyrtonte çështjen në seancë, duke qenë se ishte përpara dy vendimeve diametralisht të kundërta.

Meqenëse ai e ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi, duhet të kishte njoftuar në mënyrë të rregullt palët, në mënyrë që të kishin mundësi të mbroheshin dhe të paraqisnin komente apo prapësime lidhur me pretendimet e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën.

12.3. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka dhënë asnjë arsytim se përse nuk i ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesës

13. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik apo juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik apo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë provon interesin e tij të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Kolegji vlerëson se kërkuesi plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi i është drejtuar Gjykatës dhe shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë, duke i ngritur më parë në gjykatat e zakonshme pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual.

16. Kolegji vëren se Gjykata është vënë edhe më parë në lëvizje për shqyrtimin e një kërkeje me të njëjtin objekt, të regjistruar në Gjykatë në datën 01.11.2022, të paraqitur nga pala e

paditur në procesin gjyqësor të kundërshtuar, pjesëtarë të familjes Brahja, ku bën pjesë edhe kërkuesi. Në lidhje me këtë kërkesë, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, me vendimin nr. 44, datë 23.02.2023, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi i ka vlerësuar si haptazi të pabazuara pretendimet e kërkuësve për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të hierarkisë së akteve normative, së drejtës së pronës private, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimit të barazisë së armëve.

17. Gjykata në praktikën e saj ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës së të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji nr. 8577/2000, ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në kuptim të sa më sipër, edhe pse në kërkesën në shqyrtim kërkuesi ka paraqitur një shkak të ri për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, konkretisht në lidhje me standardin e gjykatës së caktuar me ligj dhe të drejtën e aksesit, rëndësi merr verifikimi i respektimit të afatit kohor për paraqitjen e këtyre shkaqeve të reja për gjykimin kushtetues.

19. Për sa i takon legjitimitetit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr.8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Kolegji vëren se vendimi më i fundit gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi është ai i Gjykatës së Lartë i datës 04.07.2022, kurse kërkesa në shqyrtim është paraqitur në Gjykatë në datën 04.01.2023, pra pas rreth 5 muajsh nga data e vendimit të Gjykatës së Lartë.

20. Kolegji vëren se kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument apo provë bashkëlidhur kërkesës për të provuar në nivel kushtetues se ka marrë dënim në një datë të ndryshme nga ajo e dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë dhe as në lidhje me pamundësinë e tij për t’u njohur me vendimin. Për më tepër, në kushtet kur kërkuesi ka vënë edhe më parë në lëvizje Gjykatën me kërkesë me të njëjtin objekt, Kolegji vlerëson se ai ka pasur kohë të mjaftueshme për t’iu drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual. Kolegji çmon, gjithashtu, se në kuptim të dispozitave procedurale të zbatueshme në gjykimin kushtetues, ai nuk ka pasur asnjë pengesë që të parashtronte pretendime shtesë para Gjykatës.

21. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të Gjykatës, pasi kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor. Në këtë aspekt, duke pasur parasysh natyrën kumulative të kritereve të pranueshmërisë të ankimit

kushtetues, nuk është e nevojshme të vijohet më tej me verifikimin e plotësimit të kriterëve të tjera të legjitimitit të kërkuarit.

22. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.